

4-10
MAY



EUROPE WEEK 2020



PROGRAMME PROGRAMI



STRONGER TOGETHER



The past months have not been easy for Albania. The earthquake, whose consequences are still felt by many, and the COVID-19 crisis have taken their toll on all of us.

At the same time, we have also witnessed amazing forms of solidarity, strength and resilience. Solidarity between Albanians. Solidarity of Albanians towards their friends in the European Union. Solidarity of the unparalleled support from the EU and its Member States to cope with the post-earthquake and COVID-19.

And last March, in a historical day, the European Union decided to open accession negotiations with Albania, the last important leg on its EU integration path.

Europe Week 2020 celebrates this togetherness. With the cooperation of 18 artists from our Member States and Albania, we want to honour the best that the current situation has brought out in people and offer some comfort and entertainment.

We are closer than ever. We are **stronger together**.

Luigi Soreca
EU Ambassador to Albania



Muajt e fundit nuk kanë qenë të lehtë për Shqipërinë. Tërmeti, pasojat e të cilit ende ndihen nga shumë njerëz, dhe kriza e shkaktuar nga Covid-19 kanë rënduar mbitë gjithë ne.

Në të njëjtën kohë, jemi bërë dëshmitarë të formave të mahnitshme të solidaritetit, forcës dhe qëndrueshmërisë. Solidaritet mes shqiptarëve. Solidaritet i shqiptarëve kundrejt miqve të tyre në Bashkimin Evropian. Solidaritet i mbështetjes së pakrahasueshme nga BE-ja dhe Shtetet Anëtare të saj për t'u përballur me pasojat pas tërmetit dhe Covid-19.

Ndërsa në mars, në një ditë historike, Bashkimi Evropian vendosi të hapë negociatat me Shqipërinë, etapa e fundit e rëndësishme në udhën e saj drejt integritimit në BE.

Java e Evropës kremton këtë bashkim. Me bashkëpunimin e 18 artistëve nga Shtetet tona Anëtare dhe Shqipëria, ne dëshirojmë të nderojmë më të mirën që situata aktuale ka sjellë te njerëzit dhe të ofrojmë pak qetësim dhe zbavitje.

Jemi më pranë se kurrë. Ne jemi **më të fortë së bashku.**

Luigi Soreca
Ambasador i BE-së në Shqipëri


4-10
MAY



EUROPEAN UNION
DELEGATION TO ALBANIA

EUROPE WEEK 2020

PROGRAMME



4

MONDAY

19:00 Launch of Europe Week
by EU Ambassador Luigi Soreca
AMWIN (SE)

5

TUESDAY

20:00 Ramona Tullumani (BG/AL)
21:00 Roel Van Velzen and Olta Boka (NL/AL)

6

WEDNESDAY

20:00 Stelios Kerasidis (GR)
21:00 ANDRRA (DE/KS)

7

THURSDAY

20:00 Helix Trio (CZ/AL)
21:00 Clare Sands (IE)

8

FRIDAY

20:00 Eno Peci and Maria Radutu (AT/AL/RO)
21:00 Rémi Panossian (FR)

9

SATURDAY

19:00 EU Anthem, Goran Filipec (HR)
Albanian Anthem, Laura Sulaj (PL/AL)
Message of EU Ambassador Luigi Soreca
for Europe Day 2020
Alban Skënderaj (AL)

10

SUNDAY

20:00 Duo Aritmija (SI)
21:00 Antonio Diodato (IT)
21:30 Closing of Europe Week 2020 by Al Bano (IT/AL)


4-10
MAJ



BASHKIMI EVROPIAN
DELEGACIONI NË SHQIPËRI

JAVA E EVROPËS 2020

PROGRAMI



4

E HËNË

19:00

Çelja zyrtare e Javës së Evropës
nga Ambasadori i BE-së Luigi Soreca
AMWIN (SE)

5

E MARTË

20:00

Ramona Tullumani (BG/AL)

21:00

Roel Van Velzen dhe Olta Boka (NL/AL)

6

E MËRKURË

20:00

Stelios Kerasidis (GR)

21:00

ANDRRA (DE/KS)

7

E ENJTE

20:00

Helix Trio (CZ/AL)

21:00

Clare Sands (IE)

8

E PREMTE

20:00

Eno Peci dhe Maria Radutu (AT/AL/RO)

21:00

Rémi Panossian (FR)

9

E SHTUNË

19:00

Himni i BE-së, Goran Filipec (HR)

Himni shqiptar, Laura Sulaj (PL/AL)

Mesazhi i Ambasadorit të BE-së Luigi Soreca

Alban Skënderaj (AL)

10

E DIEL

20:00

Duo Aritmija (SI)

21:00

Antonio Diodato (IT)

21:30

Mbyllja e Javës së Evropës nga Al Bano (IT/AL)



European Union in Albania

MË TË FORTË SË BASHKU

EUROPE WEEK 2020



AMWIN

Singer, Songwriter

Sweden

MONDAY 4 MAY	 19:00	 LIVE
---------------------------	-----------	----------

Amanda Winberg, performing as AMWIN, is a Swedish singer-songwriter who came to prominence through her participation in the talent show Swedish Idol in 2015, at the age of 18. After her series of singles, her acclaimed debut EP "AMWIN in Wonderland" was released in 2019. Her new EP "Where will lonely feelings go?" was released on 24 April 2020.

Every AMWIN song is an escape into a beautifully strange fantasia populated by glamorous misfits and glorious monsters, '80s movie idols and '90s rock-and-roll stars.

"AMWIN is defining her own rules for the modern music video (and the modern woman as well). It's her world and we're all just living in it" – Milk

Amanda Winberg, e cila interpreton me emrin AMWIN, është një këngëtare dhe kompozitore suedeze që u bë e njohur me pjesëmarrjen në shfaqjen e talenteve "Swedish Idol" në vitin 2015, në moshën 18 vjeçare. Pas një numri këngësh, në vitin 2019 doli në treg disku i saj debutues shumë i vlerësuar "AMWIN në botën e çudirave". Kënga e saj e re "Where will lonely feelings go?" u prezantua më 24 prill 2020.

Çdo këngë e AMWIN është një arratisje drejt një fantazie mrekullisht të çuditshme, populluar nga çudanë joshës dhe përbindësja të lavdishëm, idhuj të filmave të viteve '80 dhe yje të muzikës rock-and-roll.

"AMWIN po përcakton rregullat e saj për videot muzikore moderne (po ashtu dhe për gruan moderne). Është bota e saj dhe ne të gjithë thjesht jetojmë në të". – Milk

**EUROPE
WEEK
2020**



RAMONA TULLUMANI

Soprano

Bulgaria/Albania



Ramona Tullumani was born in Tirana and graduated from the Academy of Fine Arts in Tirana.

She followed the master classes of famous sopranos Katia Ricciarelli and Rajna Kabaivanska in Sofia, Bulgaria. In 2013, Ramona Tullumani sang in the Vatican for the birthday of Pope Francis.

Ramona Tullumani has sung in many cities such as Paris, Athens, the “Ohrid Summer Festival”, at the UN in Geneva and, every year as a special guest, at the “Three Tenors” concert in Tirana.

Since 2007, she has been United Nations 'Ambassador of Peace'.

Ramona Tullumani lindi në Tiranë dhe u diplomua në Akademinë e Arteve të Bukura në Tiranë.

Ajo ndoqi klasat master të sopranos së famshme Katia Ricciarelli dhe Rajna Kabaivanska në Sofje, Bullgari. Në vitin 2013, Ramona Tullumani këndoi në Vatikan për ditëlindjen e Papa Françeskut.

Ramona Tullumani ka kënduar në shumë qytete si Paris, Athinë, në Festivalin e Verës në Ohër, në OKB në Gjenevë dhe, çdo vit si mysafire speciale, në koncertin “Tre Tenorët” në Tiranë.

Që prej vitit 2007, ka qenë “Ambasadore e Paqes” e Kombeve të Bashkuara.

EUROPE WEEK 2020



ROEL VAN VELZEN & OLTA BOKA

Singer & Instrumentist

Netherlands/Albania

TUESDAY 5 MAY	 21:00	 LIVE
----------------------------	-----------	----------

VanVelzen became a household name in 2006 in the Netherlands and has remained present on radio and television ever since, with sixteen singles, five radio awards, a Golden Harp, five full-scale tours and over 200 festivals.

Born to be on the stage, VanVelzen sings, plays the piano and guitar, and highly engages with his audience. He and his band have become one of the most renowned Dutch live acts of their generation.

VanVelzen is active ambassador for Masterpeace - an International peace organisation connecting communities through arts and music. He has travelled with them to Congo, Albania, Georgia and Morocco, collaborating with local musicians on each trip.

VanVelzen u bë një emër i mirënjohur në Holandë në vitin 2006 dhe qysh atëherë ka qenë i pranishëm në radio dhe televizion, me gjashtëmbëdhjetë këngë, pesë çmime në radio, një çmim "Golden Harp", pesë turne të mëdha dhe mbi 200 festivale.

I lindur për të qenë në skenë, VanVelzen këndon, luan në piano dhe kitarë, si dhe angazhohet shumë me publikun e tij. Ai dhe grupi i tij janë bërë ndër interpretuesit më të njohur holandezë të brezit të tyre.

VanVelzen është ambasador aktiv i "Masterpeace" - një organizatë ndërkombëtare paqeje që lidh komunitetet përmes artit dhe muzikës. Ai ka udhëtuar me ta në Kongo, Shqipëri, Gjeorgji dhe Marok, duke bashkëpunuar në çdo udhëtim me muzikantët vendas.

EUROPE WEEK 2020



STELIOS KERASIDIS

Pianist

Greece

WEDNESDAY		
6 MAY	20:00	LIVE

Stelios was born in Athens in June 2012. At the age of five in 2017, he became the youngest pianist to have won the first prize at the two most important piano competitions in Greece, X.O.N. and FILON.

In 2018, Stelios won first prize at the international competition "Grand prize virtuoso" in the Vienna Musikverein. He also won the first prize of the 'Golden Classical Music Awards New York' and performed in Carnegie Hall.

Stelios composes his own piano pieces. Recently, his "Isolation Waltz" composed in reaction to the COVID-19 crisis had a huge impact around the world.

Stelios lindi në Athinë në qershor 2012. Në moshën pesëvjeçare, në vitin 2017, ai u bë pianisti më i ri që ka fituar çmimin e parë në dy konkurset më të rëndësishme të pianos në Greqi, X.O.N. dhe FILON.

Në vitin 2018, Stelios fitoi çmimin e parë në konkursin ndërkombëtar "Virtuoz i çmimeve të mëdha" në Musikverein të Vjenës. Ai fitoi gjithashtu çmimin e parë të "Golden Classical Music Awards New York", si dhe ka interpretuar në "Carnegie Hall".

Stelios i kompozon vetë pjesët e tij për piano. Kohët e fundit, pjesa e tij "Valsi i izolimit" i kompozuar si reagim ndaj krizës së COVID-19 pati një ndikim të jashtëzakonshëm në të gjithë botën.


EUROPE WEEK 2020



ANDRRA

Songwriter

Germany/Kosovo



ANDRRA (Fatime Kosumi) is a musician and artist whose work revolves around the link between tradition and modern society. Born in Rosenheim, Germany, ANDRRA returned for the first time to her family village in Kosovo in 2001. She currently lives and records in Berlin.

Family and heritage are central to ANDRRA's work. Her debut EP, 2017's *Palinë*, tackled issues of child marriage and female oppression in Kosovo, drawing heavily on folk lyrics and the stories of her family.

ANDRRA cites the artistic legacies of John Cage and Morton Feldman, and the bravery and freedom in the music of John Maus, as some of her sources of inspiration.

ANDRRA (Fatime Kosumi) është një muzikante dhe artiste, puna e së cilës sillet rreth lidhjes midis traditës dhe shoqërisë moderne. Lindur në Rosenheim, Gjermani, ANDRRA u kthye për herë të parë në fshatin e familjes së saj në Kosovë në vitin 2001. Ajo aktualisht jeton dhe regjistron në Berlin.

Familja dhe trashëgimia janë thelbësore për punën e ANDRRA-s. Disku i saj debutues i vitit 2017, "Palinë", trajtonte çështje të martesës së të miturve dhe shtypjes së grave në Kosovë, duke u mbështetur shumë në vargjet popullore dhe historitë e familjes së saj.

ANDRRA citon si disa nga burimet e saj të frymëzimit trashëgiminë artistike të John Cage-it dhe Morton Feldman-it, si dhe trimërinë dhe lirinë në muzikën e John Maus-it.

EUROPE WEEK 2020



HELIX TRIO

Tereza Horáková – violin

Ondřej Štochl – viola

Egli Prifti – piano

Czech Republic/Albania



The helix (spiral) is a metaphor that reflects the core concept of the Helix Trio's concerts and the overall artistic focus of the ensemble.

In harmony with this idea, the trio's goal is the empathic interpretation of works written for this non-traditional ensemble and the performance of interesting works by foreign composers in the Czech Republic and by Czech composers in other parts of the world.

The trio was founded in 2016 on the basis of a long-term cooperation level, both pedagogical and artistic.

Helix (spiralja) është një metaforë që pasqyron konceptin thelbësor të koncerteve të “Helix Trio” dhe fokusin e përgjithshëm artistik të ansamblit.

Në harmoni me këtë ide, qëllimi i trios është interpretimi empatik i veprave të shkruara për këtë ansambël jo-tradicional dhe interpretimi i veprave interesante nga kompozitorë të huaj në Republikën Çeke, si dhe nga kompozitorë çekë në pjesë të tjera të botës.

Trioja u themelua në vitin 2016 në bazë të një niveli bashkëpunimi afatgjatë, si pedagogjik, ashtu edhe artistik.

EUROPE WEEK 2020



CLARE SANDS

Singer & instrumentist

Ireland

THURSDAY 7 MAY	 21:00	 LIVE
-----------------------------	-----------	----------

Clare Sands is a passionate and alluring table dancing' & fiddle shreddin' unique force in Irish music.

A sixth-generation fiddler, creating an eclectic & energetic sound rooted in Irish Traditional Music intertwined with sultry, gravely vocals, the remarkably versatile musician, composer, performer and singer-songwriter is an unstoppable artist to be reckoned with.

'An Irish fiddle playing reincarnation of Janis Joplin', the award-winning young Sands has been wowing audiences around the world with her groundbreaking style, exceptional performance, and infinite energy. 'An impassioned voice and musical genius on stage. A unique force in Irish music' – Hotpress Magazine.

Clare Sands është një kërcimtare pasionante dhe tërheqëse, si dhe një forcë unike në lojën në violinë e muzikës irlandeze.

Një violiniste e gjeneratës së gjashtë, që ka krijuar një tingull eklektik dhe energjik, të rrënjësuar në muzikën tradicionale irlandeze, ndërthurur me një vokal të zjarrtë, të thellë, muzikantja, kompozitorja, këngëtarja dhe tekstshkruesja mjaft e talentuar, është një artiste e pandalshme që nuk duhet nënvleftësuar.

“Një violiniste irlandeze, rimishërim i Janis Joplin-it”, e reja Sands që ka fituar mjaft çmime, i ka bërë për vete audiencat në të gjithë botën me stilin e saj novator, performancën e jashtëzakonshme dhe energjinë e pafundme.

“Një zë i pasionuar dhe gjeni e muzikës në skenë. Një forcë unike në muzikën irlandeze”- Hotpress Magazine.

ENO PEÇI & MARIA RADUTU

piano and ballet

Austria/Albania/Romania

[1 of 2]

FRIDAY 8 MAY	 20:00	 LIVE
---------------------------	--	---

Eno Peçi was born in Tirana. He graduated from the ballet academy in Albania and the ballet school of the Vienna Opera. In 2009, he became a soloist ballet dancer of the Vienna Opera and the city opera.

His roles in many ballet performances took him to countries all over Europe and beyond. In 2008, he was awarded the “Honorary Ambassador” title by the Republic of Albania, and in 2017 was given the “Tirana City Key”.

In 2009, he was awarded the “Austrian Honor Cross” for science and the arts. Being a charismatic dancer, he adapts to various repertoires, thus performing as a soloist in classical, neo-classical and modern pieces.

Maria Radutu was called a "miracle" in her home country, Romania, in the 1990s when she won more than 20 piano competitions.

After her studies in Vienna, she created concept albums such as *INSOMNIA*, "a first-class musical experience", as described by the press in Vienna. Her career as a soloist led her all over Europe, Asia and the US, on stages such as Carnegie Hall, Golden Concert Hall of Vienna Konzerthaus, Festspielhaus Baden-Baden, Salle Gaveau in Paris, Auditorio Nacional in Madrid, National Hall of Concerts in Taipei and many more.

Her music goes beyond borders. She combines classical music with modern art and finds her inspiration in collaborations with artists from various fields.




ENO PEÇI & MARIA RADUTU

piano and ballet

Austria/Albania/Romania

[2 of 2]

FRIDAY 8 MAY	 20:00	 LIVE
---------------------------	--	---

Eno Peçi lindi në Tiranë. Ai u diplomua në Akademinë e Baletit në Shqipëri dhe në Shkollën e Baletit të Operës së Vjenës. Në vitin 2009, u bë balerin solist i Operës së Vjenës dhe operës së qytetit.

Rolet e tij në shumë shfaqje baleti e çuan në vende në mbarë Evropën dhe më gjerë. Në vitin 2008, atij iu dha titulli "Ambasador Nderi" nga Republika e Shqipërisë, ndërsa në vitin 2017 iu dha "Çelësi i Qytetit të Tiranës".

Në vitin 2009, atij iu dha "Kryqi Austriak i Nderit" për shkencë dhe arte. Duke qenë një balerin karizmatik, ai përshtatet me repertorë të ndryshëm, duke interpretuar kështu si solist në pjesë klasike, neo-klasike dhe moderne.

Maria Radutu është quajtur një "mrekulli" në vendin e saj, Rumani, në vitet 1990 kur fitoi më shumë se 20 konkurse pianoje.

Pas studimeve në Vjenë, ajo krijoi albume konceptuale si "INSOMNIA", "një përvojë muzikore e klasit të parë", siç u përshkrua nga shtypi në Vjenë. Karriera e saj si soliste e çoi në të gjithë Evropën, në Azi dhe SHBA, në skena të tilla si "Carnegie Hall", Salla e Artë e Koncerteve në Konzerthaus të Vjenës, "Festspielhaus Baden-Baden", "Salle Gaveau" në Paris, "Auditorio National" në Madrid, Salla Kombëtare e Koncerteve në Taipei dhe shumë të tjera.

Muzika e saj i tejkalon kufijtë. Ajo ndërthur muzikën klasike me artin modern dhe e gjen frymëzimin e saj në bashkëpunime me artistë nga fusha të ndryshme.

EUROPE WEEK 2020



RÉMI PANOSSIAN

Piano solo "DO"

France

FRIDAY 8 MAY	 21:00	 LIVE
---------------------------	-----------	----------

Lover of melodies, Rémi Panossian's live performances are energetic, captivating, and organic.

Besides his trio project with which he has performed in 30 countries on prestigious jazz stages as Tokyo, Vancouver, Montréal or Marciac, Rémi Panossian plays piano solo in the "DO" project. There, the artist expresses himself in a more direct and intimate way.

The note Do (the C note in English) means the "island" in Korean, the "way" in Japanese, the "stone" in Tibetan, "to accomplish" in English ... So many meanings to this word, so many internal resonances to Rémi Panossian.

Dashamir i melodive, interpretimet e drejtpërdrejta të Rémi Panossian-it janë energjike, tërheqëse dhe organike.

Përveç projektit të trios së tij, me të cilin ka interpretuar në 30 vende, në skena prestigjioze të xhazit si Tokio, Vankuver, Montreal apo Marsiak, Rémi Panossian luan solo për piano në projektin "DO". Aty, artisti shprehet në një mënyrë më të drejtpërdrejtë dhe intime.

Nota Do (nota C në anglisht) do të thotë "ishull" në gjuhën koreane, "mënyrë" në japonisht, "gur" në tibetisht, "të përmbushësh" në anglisht ... Kaq shumë kuptime për këtë fjalë, kaq shumë rezonanca të brendshme për Rémi Panossian-in.


EUROPE WEEK 2020



GORAN FILIPEC

Pianist

Croatia



A pianist of fiery energy and artistic personality, Mr. Filipec is a musician who never fails to capture the hearts of international audiences and critics.

Renowned for his exceptional interpretations of works of Franz Liszt and classical and romantic repertoire of high virtuosity, Goran Filipec defends creativity and subjectivity in performance, observing it as a co-creation of the musical work.

He is considered to have "three of the most important attributes that make a great pianist: artist, architect and acrobat" (Gramophone, 2018).

Mr. Filipec is co-founder and president of the Société Franz Liszt de Genève, devoted to the appreciation and study of the oeuvre of the Hungarian composer.

Një pianist me energji të zjarrtë dhe personalitet artistik, z. Filipec është një muzikant që ia del gjithnjë të rrëmbejë zemrat e audiencave dhe kritikëve ndërkombëtarë.

I mirënjohur për interpretimet e tij të jashtëzakonshme të veprave të Franc Listit dhe për repertorin klasik dhe romantik të një virtuoze të lartë, Goran Filipec mbron krijimtarinë dhe subjektivitetin në interpretim, duke e konsideruar atë si një bashkëkrijim të veprës muzikore.

Ai konsiderohet se ka "tre nga atributet më të rëndësishme që bëjnë një pianist të shkëlqyer: artist, arkitekt dhe akrobat" (Gramophone, 2018).

Z. Filipec është bashkëthemelues dhe president i Shoqatës "Franc List" të Gjenevës, që i kushtohet vlerësimit dhe studimit të veprës së kompozitorit hungarez.


EUROPE WEEK 2020



LAURA SULAJ

Pianist

Poland/Albania



Laura Sulaj was born in London in 2001 and began studying piano at the age of six.

She won the first prize in the "Frederic Chopin" competition, accompanied by the RTSH Orchestra. In May 2018, she was invited by the Chopin Society of Albania to perform in Palma de Majorca while continuing to perform at concerts in Germany and South Korea. She has performed in a number of concerts organised by the Polish Embassy and has participated in the Epinal Competition in France.

Her repertoire extends to every period, from the Baroque to the great composers, such as Mozart, Beethoven, Brahms, Rachmaninoff and, of course, Albanian composers.

Laura Sulaj lindi në Londër në vitin 2001 dhe filloi të studiojë piano në moshën gjashtëvjeçare.

Ajo fitoi çmimin e parë në konkursin "Frederik Shopen", e shoqëruar nga Orkestra e RTSH-së. Në maj të vitit 2018, ajo ishte e ftuar nga Shoqata "Shopen" e Shqipërisë për të interpretuar në Palma de Majorca, ndërsa vazhdonte të interpretonte në koncerte në Gjermani dhe Korenë e Jugut. Ajo ka interpretuar në një numër koncertesh të organizuara nga Ambasada Polake, si dhe ka marrë pjesë në konkursin "Epinal" në Francë.

Repertori i saj shtrihet në çdo periudhë, që nga baroku deri te kompozitorët e mëdhenj, si Moxart, Bethoven, Brams, Rahmaninof dhe natyrisht, kompozitorët shqiptarë.


EUROPE WEEK 2020



ALBAN SKËNDERAJ

Songwriter

Albania



Alban Skënderaj is an Albanian singer, songwriter, composer, actor, recording producer and television personality who has established himself as a very successful alternative and pop rock artist. Skënderaj rose to prominence following his victory in Top Fest (2005).

Beyond his music career, Skënderaj featured as a coach on the Albanian television talent competition series The X Factor Albania and The Voice of Albania.

Alban Skënderaj është një këngëtar, tekstshkrues, kompozitor, aktor, producent regjistrimi dhe personalitet televiziv që e ka treguar veten si një alternativë shumë të suksesshme dhe artist i muzikës pop rock. Skënderaj u bë mjaft i njohur pas fitores së tij në Top Fest (2005).

Përtej karrierës së tij muzikore, Skënderaj është shfaqur edhe si trajner në seritë e konkursit të talenteve televizive shqiptare “The X Factor Albania” dhe “The Voice of Albania”.

EUROPE WEEK 2020



DUO ARITMIJA

Dino Murtezani – vocals, kaval, lute
Tilen Stepišnik – guitar, tambura
Šemsudin Dino Džopa – guitar, mandolin
Andrej Tomazin – percussions

Slovenia



Dino Murtezani Project is a world-music group performing traditional music of Albania and the Balkan region, arranged by the musicians, as well as their own original compositions. The project is led by multi-instrumentalist and vocalist Dino Murtezani, whose main instrument is a mystical kaval, a traditional end-blown flute played throughout the Balkans. Murtezani also plays the clarinet, mandolin and lute. Building on their long-standing musical collaboration, Murtezani has joined forces with multi instrumentalists of the renowned Slovene classical and acoustic guitar duet Aritmija, Tilen Stepišnik and Šemsudin Dino Džopa. For this very occasion the percussionist Andrej Tomazin will join them on darbuka, cajon and udu.

For their special Europe Week 2020 in Albania concert, Dino Murtezani Project will be performing a set of Albanian traditional songs as well as Murtezani's original composition, Ples lastovk (The Dance of the Swallows).

Photographer Jan Prpič

Projekti Dino Murtezani është një grup muzikor që interpreton muzikë tradicionale të Shqipërisë dhe rajonit të Ballkanit, aranzhuar nga muzikantët, si dhe kompozimet e tyre origjinale. Projekti drejtohet nga multi-instrumentisti dhe vokalisti Dino Murtezani, instrumenti kryesor i të cilit është një kaval mistik, një flaut tradicional që luhet në të gjithë Ballkanin. Murtezani luan edhe në klarinetë, mandolinë dhe lahutë. Bazuar në bashkëpunimin e tyre të gjatë muzikor, Murtezani ka bashkuar forcat me multi-instrumentistët e duetit të njohur sloven të kitarës klasike dhe akustike "Aritmija", Tilen Stepišnik dhe Šemsudin Dino Džopa. Pikërisht për këtë rast, perkusionisti Andrej Tomazin do të bashkohet me ta në darbuka, cajon dhe udu.

Për koncertin e tyre special të Javës së Evropës 2020 në Shqipëri, Projekti Dino Murtezani do të interpretojë një numër këngësh tradicionale shqiptare, si dhe kompozimin origjinal të Murtezanit "Ples lastovk" (Vallja e harabelave).


EUROPE WEEK 2020



ANTONIO DIODATO

Singer, Songwriter

Italy



Diodato's career is tightly linked to the Sanremo Festival. In 2014, he wins second place in the newcomers category. In 2017 he won the Critic's Choice award. He returns as a guest in 2019 and wins in 2020 with the song "Fai Rumore", topping the Italian charts.

Diodato was scheduled to represent Italy in the Eurovision Song Contest 2020 in Rotterdam, before this event was cancelled due to the COVID pandemic.

Antonio is well-known for his social engagements. Since 2016 he has been in charge of the artistic direction of the May Day Concert in Taranto, which combines music performances and the defence of universal rights. In 2017, he participated in #EveryChildisMyChild - Live for Syria, to support the construction of schools in Syria.

Karriera e Diodatos lidhet ngushtë me Festivalin e Sanremos. Në 2014, fiton vendin e dytë në kategorinë e të rinjve. Në 2017, Çmimin e Kritikës. Rikthehet si i ftuar në 2019 dhe fiton në 2020 me këngën "Fai Rumore", duke arritur në krye të klasifikimeve italiane.

Diodato ishte planifikuar të përfaqësonte Italinë në Festivalin e Këngës në Eurovizion 2020 në Roterdam, përpara se ky event të anulohet për shkak të pandemisë COVID.

Antonio njihet për angazhimet e tij shoqërore. Nga viti 2016 ka qenë në krye të drejtimit artistik të Koncertit të Ditës së 1 Majit në Taranto, i cili ndërthur shfaqjet muzikore dhe mbrojtjen e të drejtave universale. Në vitin 2017, mori pjesë në #EveryChildisMyChild - Live for Siria, për të mbështetur ndërtimin e shkollave në Siri.

EUROPE WEEK 2020



AL BANO

Singer, Songwriter

Italy/Albania



Al Bano is one of Italy's most popular and cherished singers. His victories on the stage of festivals in the 1960's paved the way for his recording career, with world-known hits like "Felicità" and "Sempre Sempre".

In July 1970, Al Bano married artist Romina Power, with whom he became a very successful duet for the following 30 years. Al Bano & Romina Power made regular appearances at the Sanremo Festival and Eurovision Song Contest, consistently placing well and earning a loyal following.

In 2016, AL Bano received Albanian citizenship, after having previously been honoured with the "Skanderbeg Order". Al Bano was the first Western artist to perform in Tirana in 1989 in front of tens of thousands of people, singing songs of freedom.

Al Bano është një nga këngëtarët më të njohur dhe më të dashur të Italisë. Fitoret e tij në skenën e festivaleve në vitet 1960 i hapën udhë karrierës së tij të regjistrimeve, me suksese të njohura në mbarë botën si "Felicità" dhe "Sempre Sempre".

Në korrik 1970, Al Bano u martua me artisten Romina Power, me të cilën u bë një duet shumë i suksesshëm për 30 vitet e ardhshme. Al Bano & Romina Power janë shfaqur rregullisht në Festivalin e Sanremos dhe në Festivalin e Këngës në Eurovizion, duke zënë vazhdimisht vende të mira dhe duke fituar ndjekës besnikë.

Në vitin 2016, AL Bano mori nënshtetësinë shqiptare, pasi ishte nderuar më parë me "Urdhrin e Skënderbeut". Al Bano ishte artisti i parë perëndimor që interpretoi në Tiranë në vitin 1989 para dhjetëra mijëra njerëzve, duke kënduar këngë për lirinë.